



PROPOZIM

**RREGULLORE PËR TATIMIN
MBI PRONËN E PALUAJTSHME**

PËR VITIN TATIMOR 2013

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme, Ligjit Nr.04/L-100 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 4.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale dhe Statutit të Komunës, Kuvendi Komunal i Shtërpcës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____, aprovon këtë:

DRAFT

RREGULLORE MBI TATIMIN NË PRONË

Neni 1.

1.1. Duke u bazuar në Nenin 6 Ligjit Nr.03/L-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme baza tatimore do të caktohet si më poshtë:

Sipas Zonave në bazë të vlerës së tregut në m²

Zona tatimore	I	II	III	IV	V
Objektet komerciale	1080	480	350	310	270
Objektet industriale	1000	410	320	280	240
Objektet bujqësore	990	300	180	150	110
Objektet e banimit	990	300	180	150	110
Prona e pakryer	396	120	72	60	44

1.2. Udhëzimi Administrativ Nr.03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave për pronën dhe tatimpaguesin përcakton koeficientët e vlerësimit të gjendjes së ndërtesës .

Neni 2.

2.1 Duke u bazuar në vendndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj, në Komunën e Shtërpcës janë përcaktuar V zona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pronës.

Neni 3.

Zona e I përfshinë:

- Lagjen e vikendit, gjegjësisht zonën e vikendit ose zonën speciale.

Zona e II përfshinë:

- Shtërpcën, deri te lagja Kecini dhe Doganxhini;
- Berevcin deri te lumi Lepenc;
- Brezovicën (e tëra) dhe
- Jazhincën (Barice)

Zona e III përfshinë:

- Shtërpcën nga Kecinët dhe Doganxhinët e më tutje dhe
- Berevcin nga Lepenci e më tutje.

Zona e IV përfshinë:

- Bitia e Poshtme;
- Bitia e Epërme;
- Gotovusha;
- Drekoci;
- Viça;
- Jazhinca nga Barice në drejtim të Sevcës;
- Sevca;
- Vërbeshtica;
- Firaja dhe
- Brodi.

Zona e V përfshinë:

- Sushiqi;
- Kashtaneva dhe
- Izhanci.

Neni 4.

4.1 Në pajtim me neni 2 të Ligjit Nr.04/L-100 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme, shkallët tatimore për vitin tatimor 2013 për Komunën e Shtërpcë janë siç vijon:

Shkalla tatimore për vlerësimin e shumës së tatimpaguesit është:

Për pronën objektet komerciale..	0.25%
Për pronën objektet industriale	0.20%
Për pronën objektet bujqësore.....	0.17%
Për pronën objektet e banimit	0.15%

Në shumën e vlerës së qarkullimit të pronës së objektit (baza e tatimit).

Neni 5.

5.1. Pronat të cilat lirohen nga tatimi në prone e të cilat janë të cekura ne nenin 8 Ligjit Nr.03/L-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Shterpcë

Neni 6.

6.1 Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veçanta mund të bëhet konform nenit 16 të Ligjit Nr.03/L-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme.

Neni 7

7.1 Në pajtim me nenin 22 të Ligjit Nr.03/L-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme, dhe Udhëzimit Administrativ 05/2011 neni 1. Kryetari i komunës Shterpcë emron Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve për vitin 2013 .

Neni 8.

8.1. Ligji Nr.03/L-204 Për tatimin në pronën e paluajtshme, Ligji Nr.04/L-100 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme në Kosovë dhe udhëzimet administrative rregullojnë të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë më tatimin në pronë e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

Neni 9.

9.1. Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe e njëjta do të zbatohet për vitin 2013.

Më: _____
Në:

Kryetari i komunës
